



01/Nr.6765/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 40, 68, Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna neni 6, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit me numër 01/Nr.4240/2023 neni 80, 81, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 merr:

**VENDIM**  
**PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E Pjesërishëm të Rregullores për Taksa Komunale për vitin 2025**

1. Me këtë vendim aprovohet Rregullorja për Taksa Komunale për vitin 2025.
2. Rregullorja për Taksa Komunale për vitin 2025 lëshohet në procedurë të diskutimit publik me qytetarë vetëm te neni 4 (katër).
3. Obligohet Drejtoria për Administratën e Përgjithshme që t'i zhvilloj procedurat e diskutimit publik me qytetarët dhe pas kësaj rezultatet e diskutimit publik t'i paraqet në Kuvendin e Komunës për finalizimin e Rregullores për Taksa Komunale për vitin 2025.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për Taksa Komunale për vitin 2025.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Zhvillim Ekonomik,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 30.08.2024

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta





01/Nr.7044/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 40, 68, Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna neni 6, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit me numër 01/Nr.4240/2023 neni 80, 81, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 merr:

### VENDIM

#### PËR PLOTSIMTËSIM NDRYSHIMIN E PJESËRISHËM TË RREGULLORES PËR KUSHTET KRITERET DHE PROCEDURAT E NDARJES SË SUBVENCIONEVE

1. Me këtë vendim aprovohet plotësim ndryshimi i rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.
2. Plotësim ndryshimi i rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve është te neni 7 pika 7.2, neni 14.2, të cilët do të nënshtrohen procedurave për të diskutimit publik me qytetarët.
3. Obligohet Drejtoria për Arsim t'i zhvilloj procedurat e diskutimit publik me qytetarët dhe pas kësaj rezultatet e diskutimit publik t'i paraqet në Kuvendin e Komunës për finalizimin e plotësim ndryshimit të rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është plotësim ndryshimi i rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve.
5. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Arsim,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 30.08.2024

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta







01/Nr.6768/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11,12.1, 12.2 shkronja (d), 40, Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr.08/L-025 neni 28, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit me numër 01/Nr.4240/202023 neni 11, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 merr:

### VENDIM

#### PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR CILËSI TË AJRIT NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT PËR VITET 2024-2029

1. Kuvendi i Komunës miratoi propozim vendimin me numër 06/Nr.6768/2024 për Planin Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit në territorin e Komunës së Hanit të Elezit për vitet 2024-2029.
2. Plani Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit në territorin e Komunës së Hanit të Elezit për vitet 2024-2029 përmban gjithsej 61 (gjashtëdhjetë e një) faqe dhe është pjesë përbërëse e këtij vendimi, i cili parasheh mënyrën e veprimit për mbrojtjen e cilësisë së ajrit.
3. Mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokolimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit  
Data: 30.08.2024

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta





01/ Nr.7062/2024

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12,40, Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera, si dhe Rregulloren (QRK) –Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera neni 31, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2024 merr:

VENDIM  
PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË KOMISIONIT KOMUNAL PËRFUNDIMTAR PËR VLERËSIMIN E DËMEVE  
NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FATKEQËSITË E TJERA

1. Kuvendi i komunës miratoi raportin e komisionit komunal përfundimtar për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera dëmi i cili u shkaktua nga rënia e breshrit në Komunën e Hanit të Elezit me datë 21.05.2024.
2. Duke ju referuar nenit (1) të këtij vendimi vlerësimi i dëmeve në sektorin e bujqësisë është në shumë prej 58,050.00 €, vlerësimi i dëmeve në ekonomi familjare është në shumë prej 248,319.43 €, vlerësimi i dëmeve në vetura është në shumë prej 451,460.53 €, vlerësimi i dëmeve në biznese është në shumë prej 24,242.50 €, vlerësimi i dëmeve në institucionet komunale është në shumë prej 62,805.50 €. Shuma totale e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera është 844,877.96 €.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë.
4. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas protokollimit të autoritetit mbikëqyrës dhe 7 ditë pas publikimit në ueb – faqen zyrtare të komunës.

Me këtë vendim njoftohen:-

- Kryetari i Komunës,
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë,
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe
- Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit  
Data: 30.08.2024

Kryesuesi i Kuvendit  
Florim Shkreta

